VENDIM
Nr. 22, datë 18.1.2017

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME, NGA FONDI REZERVË I BUXHETIT TË SHTETIT, PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE QË RRJEDHIN NGA ZBATIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE PËR VIKTIMAT E NGJARJES SË 21 JANARIT 2011

(Ndryshuar me VKM nr. 743, datë 13.12.2017)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, i shtohet fondi prej 160 011 479 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, akordohet për Gardën e Republikës së Shqipërisë, për shlyerjen e detyrimeve sipas vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja Nr. 1/1 *(Ndryshuar me vendimin nr. 743, datë 13.12.2017)*

Rasti	**Gjykata**	**Vlera e detyrimit**
Vendimi nr. 3968, datë 28.7.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	42 021 626 lekë
Vendimi nr.6148, datë 21.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	23 619 896 lekë
Vendimi nr. 6292, datë 28.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	18 836 416 lekë
Vendimi nr. 6242 datë 27.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, i formës së prerë	75 533 541 lekë
Totali i detyrimeve, i shlyer me fondin e çelur sipas VKM-së nr. 22 datë 18.1.2017		**Vlera 160 011 479 lekë**
Vendimi nr. 944, datë 10.3.2017	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	23 334 741 lekë
Vendimi nr. 382, datë 9.2.2017	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	32 223 356 lekë
Vendimi nr. 179, datë 30.1.2017	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	73 853 897 lekë
Shpenzime të tjera gjyqësore, sipas vendimit nr. 24, datë 7.3.2017, "Për ndreqje gabimi në vendimin nr. 6242, datë 7.3.2017	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë,	97 300 lekë
Shpenzime të tjera gjyqësore, sipas vendimit nr. 16, datë 8.2.2017, "Për ndreqje gabimi në vendimin nr. 6292m, datë 28.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë,	163 300 lekë
Totali i detyrimeve të fondit shtesë, sipas pikës 1, të këtij vendimi		**Vlera 129 672 594 lekë**